



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 155, Datë 13.06.2022

MBI

**MIRATIMIN E KALENDARIT TË MASAVE TË ENTIT TË RREGULLATOR TË
ENERGJISË PËR FILLIMIN E ZBATIMIT DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2021 MIRATUAR NGA
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Pjesës I, Kreu II, pika 1 të vendimit nr. 134/2018, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 03.09.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/6 prot., datë 20.05.2022, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi miratimin e kalendarit të masave të Entit të Rregullator të Energjisë për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësisimit të rekomandimeve të Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021 miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë”,

Konstatohet se:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me shkresën me nr. 1244/2 prot., datë 05.05.2022, ka përcjellë në ERE Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021”.
- Me vendimin nr. 134/2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është shprehur “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.
- Manuali i monitorimit vjetor dhe periodik shërben për zbatimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- Me qëllim marrjen e masave për zbatimin me përpikmëri të parashikimeve të Manualit, Kryetari i ERE me Urdhrin nr. 68, datë 04.05.2022, ngriti Grupin e Punës në përbërje të të cilit janë anëtarë drejtues të të gjitha strukturave të ERE-s, me detyrë hartimin dhe

vënien në funksionim të një kalendarit masash për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të Kuvendit.

- Në zbatim të Urdhrit nr. 68, datë 04.05.2022, Grupi i Punës hartoi Kalendarin e Masave, sipas detyrave të vendosura nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, për zbatim nga ERE përgjatë vitit 2022.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Kalendarit të Masave të Entit të Rregullator të Energjisë” për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të rezolutës për vlerësimin e veprimitarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2021, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (Bashkëlidhur)
2. Grupi i Punës, t’i raportojë bordit të ERE-s, jo më vonë se java e parë e çdo muaji, në lidhje me ecurinë e zbatimit të Kalendarit të Masave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Petrit AHMETI